



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 499/6 Akti

Tiranë, më 27.11.2018

### V E N D I M

Nr.94, Datë 27/11/2018

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Himarë,

### VËREJ SE:

Me vendimin nr. 58, datë 06.06.2018 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Himarë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit

civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 499/1 prot., datë 06.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 499/4 prot., datë 26.10.2018 “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Himarë”, i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë Himarë.

Pas kësaj, me shkresën nr. 3121/1 prot., datë 16.11.2018 “Dërgohet projektraporti i nënshkruar” (protokolluar në KMSHC me nr. 499/5 prot., datë 19.11.2018), institucioni ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Kryetari i Bashkisë, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në

ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*, “*Specialist IT*”, në Njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, emëruar me aktin nr. 5, dt. 9.1.2018.
2. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Zyrës Juridike*”, emëruar me aktin nr. 29, dt. 29.2.2016.
3. \*\*\*\*\*, “*Specialist jurist i gjyqësorit*”, emëruar me aktin nr. 146, dt.1.9.2015.
4. \*\*\*\*\*, “*Specialist, jurist për pronat publike*”, në Zyrën Juridike, emëruar me aktin nr. 159, dt. 4.12.2017.
5. \*\*\*\*\*, “*Specialist i financës*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 19, dt. 6.2.2018.
6. \*\*\*\*\*, “*Specialist i financës*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 34, dt. 5.3.2018
7. \*\*\*\*\*, “*Specialist i Buxhetit*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 156, dt. 14.11.2017.
8. \*\*\*\*\*, “*Specialist i shërbimit veterinar*”, në Drejtorinë Pyje-Kullota, (Lukovë), pika 5 e aktit nr. 153, dt. 1.9.2015.
9. \*\*\*\*\*, “*Koordinator*”, emëruar me aktin nr. 7, dt. 09.1.2018.
10. \*\*\*\*\*, “*Koordinator*”, emëruar me aktin nr. 148, dt. 07.11.2017.
11. \*\*\*\*\*, “*Kontabilist i shpenzimeve dhe të ardhurave*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 62, dt. 29.02.2016
12. \*\*\*\*\*, “*Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës*” emëruar me aktin nr. 28, dt. 28.2.2017.
13. \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist topograf*”, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, emëruar me aktin nr. 57, dt. 29.2.2016.

Njësia përgjegjëse, të planifikojë dhe organizojë zhvillimin e këtij procesi, duke siguruar që konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, mbështetur në nenet 22, 23 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.

3. Kryetari i Bashkisë, në zbatim të nenit 111, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, të nxjerra në kundërshtim me procedurat për ngritje në detyrë, të përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:
  - akti nr. 150 prot., dt. 7.11.2017, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave (Tatim-Taksa)*”
  - akti nr. 60, dt. 29.02.2016, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës taksa familjare*”

- akti nr. 38, datë 29.2.2016, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “Drejtor i shërbimeve sociale, turizëm, arsim, kulturë, sport”.
- akti nr. 37/1 prot., datë 15.6.2016, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Mirëqenies dhe Kujdesit Social”.

Njësia përgjegjëse, duhet të trajtojë nëpunësit sipas kategorisë së pozicionit të punës, në të cilin ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe të vlerësojë mundësinë e sistemimit të tyre në pozicionet e punës në kategorinë që ata e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit. Punonjësit e mësipërm, nuk kanë asnjë pengesë për të konkurruar nëse i përmbushin kërkesat ligjore.

4. Njësia përgjegjëse, para se të fillojë procesin e rekrutimit, për të plotësuar vendet vakante, të hartojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019 dhe t’ia dërgojë për miratim Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me nenin 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”. Në këtë akt, të përcaktohet: numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë; rastet përjashtimore nëse do të pranohen dhe kandidatë të tjerë për të aplikuar në procedurat e ngritjes në detyrë, si dhe kërkesa të tjera ligjore. Ky proces duhet të ketë përfunduar brenda muajit shkurt të çdo viti kalendarik.

Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që plani vjetor i nevojave për rekrutim në shërbimin civil, të bëhet publik në faqen zyrtare të “Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat për informimin e publikut, në mënyrë që konkurrimet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ligji.

5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Himarë, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas procedurave specifike të përcaktuara në ligj, për punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil para fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si më poshtë:

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste e regjistrimit dhe procedurave”, në Drejtorinë e të Ardhurave (Tatim-Taksa). Në shkurt 2014, ishte e punësuar në pozicionin “Inspektore

e regjistrimit të procedurave” në Bashkinë Himarë, e punësuar në këtë pozicion që nga data 28.8.2013.

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste e regjistrimit dhe procedurave”, në Drejtorinë e të Ardhurave (Tatim-Taksa). Me kontratën nr. 3, dt. 03.1.2014, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së të ardhurave” Lukovë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Inspektor i vlerësimit dhe Kontrollit të Biznesit”, në Drejtorinë e të Ardhurave (Tatim-Taksa). Me aktin nr. 32, dt. 14.5.2007, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së tatimeve” në ish Komunën Lukovë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Përgjegjës i menaxhimit kadastral”, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës. Në shkurt 2014, ishte i punësuar në pozicionin “Drejtor i zyrës së MMT” në Bashkinë Himarë, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 17, dt. 28.02.2014, pika 30.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Pyje-Kullota”. Me aktin nr. 17, dt. 28.2.2014 (nr. 33), është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i zyrës pyje-kullota” në Bashkinë Himarë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i shërbimit veterinar”, në Drejtorinë Pyje-Kullota. Në shkurt 2014, ishte i punësuar në ish Komunën Vranisht.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes”. Me aktin nr. 17, dt. 28.2.2014 (nr. 17), është emëruar në pozicionin “Inspektor i shërbimeve të infrastrukturës” në Bashkinë Himarë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Përgjegjës i sektorit të ambienteve publike”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes. Me aktin nr. 17, dt. 28.2.2014 (nr.15), është emëruar në pozicionin “Specialist i nivelit të lartë urbanist” në Bashkinë Himarë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i veprimtarive të kulturës”, në Sektorin social, rinisë, kulturës, turizmit. Me aktin nr. 17, dt. 28.2.2014 (nr. 17), është emëruar në pozicionin “Inspektore e kulturës”.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i sportit”, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. Në shkurt 2014, ishte i punësuar në pozicionin “Inspektor i sportit”, emëruar me kontratë datë 1.9.2011.

Akti i deklaramit t’i njoftohet nëpunësve, me qëllim garantimin e të drejtave që lindin në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dalta në zbatim të tij.

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin për të përfunduar hartimin e përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në

Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit gjatë vitit 2018, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore t'i njoftojë të gjithë punonjësit që ligji i ngarkon me detyrën e hartimit të përshkrimeve të punës, me vendimin e Komisionerit, pasi në përfundim të afatit të paralajmërimit, përgjegjësia do të jetë personale për nëpunësin që nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në vendim.

7. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit dhe punonjësit përgjegjës, duhet të përfundojnë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018, të ndarë në dy 6 mujorë. Njësia përgjegjëse duhet të ndjekë procesin me qëllim që të respektohen afatet, duke drejtuar edhe punonjësit e tjerë, në rolin e zyrtarit raportues, zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues, sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Rezultatet e procesit të vlerësimit, të përfshihen në Regjistrin Qendror të Personelit, nëpërmjet depozitimit të formularit të vlerësimit për çdo nëpunës civil, të përcaktuar në vendimin e Komisionerit.

Ky proces duhet të ketë përfunduar me plotësimin e afatit të paralajmërimit. Njësia përgjegjëse duhet të njohë të gjithë punonjësit që do të realizojnë këtë proces, me raportin e mbikëqyrjes pasi, përgjegjësia do të jetë personale për nëpunësin që nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në vendim.

8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi si dhe të dërgojë dokumentacionin që vërteton masat e marra për të rregulluar situatën e ligjshmërisë.

- 10.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Himarë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe Ministria e Brendshme.
- 11.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 12.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**